



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:232504

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474576

PPP.nr.219/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit “DSK A.” SHPK, me seli në Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Besmir Rrahmani nga Ferizaj, kundër debitorit F.M. nga Ferizaj, rr “...”, nr..., për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, më datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit F.M., i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.330/2022, të datës 19.10.2022, i lëshuar nga përmbareuesi privat Sh.L. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.330/2022, i datës 19.10.2022.

II DETYROHET debitori F.M., nëse parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, që në bazë të nenit 78, par 1 dhe 2, të LPP-së, ta deponoj në llogarinë e kësaj gjykate shumë e garancionit prej 1,000 euro.

A r s y e t i m

Me urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.330/2022, të datës 19.10.2022, përmbareuesi privat Sh.L., e ka caktuar përmbareimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit “DSK A.” SHPK, kundër debitorit F.M., për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në shumë prej 1,000 euro dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremit, në bazë të faturës nr..., e datës

05.09.2022, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të kreditorit ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi si i bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.330/2022, i datës 19.10.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat Sh.L., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, në të cilin është përcaktuar shprehimisht se fatura konsiderohet dokument i besueshëm në bazë të cilës mundë të caktohet përmbarimi.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se kreditori këtë borxh e kërkon vetëm në bazë të kësaj fature por pa kurrfarë kontrate të përpiluar dhe të nënshkruar në mes të kreditorit dhe debitorit, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar dhe të paqëndrueshëm sepse në rastin konkret, siç vërtetohet nga shkresat e kësaj lënde, Përmbaruesi Privat Sh.L.1 urdhrin e atakuar me prapësim e ka nxjerrë në bazë të faturës nr.01/S/2022, e datës 05.09.2022 dhe bazuar në nenin 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, për faktin se fatura e cekur më lart konsiderohet dokument i besueshëm në bazë të cilës mundë të caktohet përmbarimi sepse e njëjta është e nënshkruar nga kreditori dhe debitori. Për më tepër, fatura lëndore, siç shihet e njëjta është në tërësi e përshtatshme për përmbarim, gjegjësisht në pajtim me nenin 29, par 3, të LPP-së, dhe në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjithashtu, Gjykata konstaton se fatura lëndore i plotëson edhe kushtet ligjore nga neni 30, i LPP-së, në të cilën nga kreditori është shënuar edhe afati i pagesës së borxhit nga debitori, gjegjësisht afati për pagesën e borxhit është data 23.08.2022. Për më tepër, propozimi për përmbarrim i kreditorit siç shihet i njëjti është përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse i njëjti e përmban kërkesën për përmbarrim, në të cilën është treguar dokumenti i besueshëm në origjinal, kërkuetin e përmbarrimit dhe debitorin, adresën e vendbanimit dhe të selisë së kreditorit, gjegjësisht adresën e vendbanimit të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.

Po ashtu, pretendimi i debitorit në prapësim se kreditori nuk i ka kryer të gjitha obligimet sipas marrëveshjes gojore për nxjerrjen e vizës për të shkuar në perëndim. Duhet theksuar se viza nuk është marr fare dhe në arsyetimin e kreditorit theksohet se dokumentacioni nuk ka qenë komplet dhe se fare nuk mundesh që të aplikosh për vizë, ky udhëtim për në perëndim nuk është realizuar sepse kreditori nuk ka mundur që më pajis me vizë Gjermane në mënyrë që të mund të udhëtoj në këtë shtet sepse nuk është siguruar viza e udhëtimit, çka donë të thotë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të marrëveshjes gojore në mes të kreditorit dhe debitorit, Gjykata konsideron se edhe ky pretendim është i pa bazuar, për arsye se gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim gjykata nuk mund të bëj hetim të fakteve apo rrethanave se si ka ardhur deri te marrëveshja gojore në mes palëve për sigurimin e vizës për debitorin.

Gjykata me rastin e detyrimit të debitorit si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, që në rast të ushtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, ta deponoj shumën e mjeteve prej 1,000 euro, është bazuar në nenin 78, par 1 dhe 2, të LPP-së.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.330/2022, i datës 19.10.2022, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.219/22, më datë 19.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.